

KOMUNA ISTOG - PLANI I VEPRIMIT PËR BRAKTISJE DHE REGIM NDAJ BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË FËMIJEVE NË SHKOLLA - 2025/2026 - 2028-2029

Pas analizës së gjendjes dhe raundeve të konsultimit me akterët qendror dhe lokal, komuna duke ri analizuar praktikat sipas trendëve dhe përmes rishikimit të PLANIT TË VEPRIMIT PËR BRAKTISJE DHE REGIM NDAJ BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË FËMIJEVE NË SHKOLLA në pjesën e dytë të vitit 2025 ka përcaktuar objektivat e sajë primare për të cilat është hartuar një plan përkatës i veprimit përmes aktiviteteve të synuara. Nga Analiza e gjendjes dhe nivelet e konsultimit dhe mbi bazën e analizës së të dhënave/informatave për fushat në të cilat kërkohet ndërhyrje janë përshtatur ri dimensionuar objektivat të cilat gjithashtu janë në përputhje me dokumentet strategjike në sistemin e arsimit. Objektivat janë caktuar duke përdorur qasje sistematike dhe janë nxjerrë në bazë të fushave specifike të cilat janë konsideruar të rëndësishme, koherente dhe të qëndrueshme. Në mënyrë që të arrijmë rezultate të qëndrueshme, qëllimi ishte të fokusohemi në dy apo tri fusha kryesore ku do të ruhen dhe aplikohen seriozisht standardet e nevojshme për tu siguruar se veprimet ruajnë standardet esenciale të sistemit të arsimit në funksion të gjithë përfshirjes , edhe pse nga analiza e gjendjes janë identifikuar edhe shumë çështje të tjera të cilat duhet të adresohen por në kuadër të aktiviteteve në qasjen analitike ndikohet pozitivisht gjithë sistemi i arsimit.

Objektivat prioritare të komunes:

1. Funksionimi i Ekipëve Shkollore për Parandalim të Braktisjes dhe Mos regjistrimit të fëmijëve në shkolla, përmes aplikimit të përgjegjësisë institucionale, planifikimit dhe veprimit sipas nevojës duke u bazuar në adresimin dhe raportimin standard koherent dhe të avancuar në menaxhimit të rasteve të identifikuar dhe adresimi të institucionet përgjegjëse në linjën e komunikimit institucional.
2. Identifikimi dhe Integrimi i fëmijëve jashtë shkollës përmes aplikimit të mekanizmave në kontestin human dhe ligjor në sistemin e arsimit të cilët adresojnë çështjet e braktisjes dhe mos regjistrimit të fëmijëve në shkolla në bashkëpunim me ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit të nxënësve në shkolla, departamenteve institucionale relevante, prindërve dhe komunitetit në afërsi të shkollës.
3. Fuqizimi i kontestit profesional të komunitetit të Institucioneve në Arsimin para universitar duke aplikuar dhe zhvilluar kapacitetet profesionale në trajtimin e specifikave në procesin e mësimdhënies dhe përkrahjes së nxënësve sipas nevojave të profilit social dhe akademik si dhe në përdorimin e gjuhës adekuate në raportet sociale brenda institucioneve dhe sigurimi personelit adekuat e të mjaftueshëm dhe infrastrukturës adekuate arsimore dhe hapësirave fizike bazuar në nevoja dhe trendët..

<u>OBJEKTIVI - 1</u>	Fuqizimi i Ekipeve Shkollore për Parandalim të Braktisjes dhe Mos regjistrimit të fëmijëve në shkolla, përmes aplikimit të përgjegjësisë institucionale, planifikimit dhe veprimit sipas nevojës duke u bazuar në adresimin dhe raportimin standard koherent dhe të avancuar në menaxhimin të rasteve të identifikuar dhe adresimi të institucionet përgjegjëse në linjën e komunikimit institucional.					
<u>Treguesi i rezultatit</u>	Numri i rasteve të menaxhuara Numri i fëmijëve të integruar					
<u>Aktivitetet</u>	Përgjegjësit	Palët Ndihmese	Afati kohore	Kosto	Burimi i financimit	Treguesit
1.1- Planifikimi i punës përmes hartimit dhe zhvillimit të planit shkollor të veprimit në kuadër të shkollës kundër braktisjes dhe reagimit ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit të fëmijëve në shkollë bazuar në analizën e situatës përmes identifikimit të çështjeve kyçe dhe problemeve të bazuara sipas situatës „ku jemi tani?” dhe planifikimi i caktuar „ku dëshirojmë të jemi”	EPMRB shkollat	DKA OJQ QPS ZKKK Shkollat	Q4	50 x11=550	SHKOLLAT DONATOR TË MUNDËSHEM	Mostra standarde e planit të veprimit
1.2 - Zbatohen procedurat standarde të veprimit në kuadër të shkollës si mekanizma strukturimi në adresimin e çështjeve përmes përdorimit të formularëve si rregulla të funksionimit dhe raportimit nga ekipi në çdo fazë dhe me gjithë akteret kundër braktisjes dhe mos regjistrimit	EPMRB Shkolla	DKA DSH QPS OJQ ZKK	Q1&DH4	SKA	SHKOLLAT	Mostrat standarde të instrumenteve si pas strukturës së adresimit të çështjeve

2.3 - Zhvillimi kapaciteteve profesionale përmes organizmit të trajnimeve dhe sesione informuese për anëtarët e ekipeve me qëllim të ngritjes së efikasitetit në menaxhimin dhe adresimin e rasteve të braktisjes, reagimit ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit	MASHTI DKA Shkolla	OJQ QPS	SH1&Q4	800	MASHT DKA DONATOR TË MUNDËSHEM	Numri i trajnimeve dhe sesioneve të realizuara
2.4 - Organizimi i takimeve të rregullta të ekipeve shkollore duke u bazuar në vlerësime analitike në raport me organizimin e sistemit arsimor me qëllim të analizës së situatës si mundësi për reagimin e hershem dhe takimeve sipas nevojës	EPMRB në nivelin shkollor	OJQ QPS ZKKK DKA	SH1&Q4	20 x11=220	SHKOLLAT DONATOR TË MUNDËSHEM	Numri i takimeve të realizuara në periudha që mundësojnë reagimin e hershem-Raportet
2.5 – Të organizohen iniciativa dhe takime afirmative dhe specifike në nivel shkolle dhe në komunitet individuale dhe të përbashkëta me karakter sensibilizues dhe aktivitete të tjera ndihmëse për fëmijët braktisës dhe fëmijë në rrezik të braktisjes	Shkolla	DKA QPS DSH ZKKK OJQ	Q1&Q4	SKA	SHKOLLAT DONATOR TË MUNDËSHEM	Numri i aktiviteteve të kryera
2.6 - Raportimi të EPBRM së shkollës të EPBRM komunale sipas nevojës	Shkolla	DKA	SH1&Q4	SKA	SKA	Raporti i takimeve dhe raportet e shkruara

<u>OBJEKTIVI - 2</u>	Identifikimi dhe Integrimi i fëmijëve jashtë shkollës përmes aplikimit të mekanizmave në kontestin human dhe ligjor në sistemin e arsimit të cilët adresojnë çështjet e braktisjes dhe mos regjistrimit të fëmijëve në shkolla në bashkëpunim me ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit të nxënësve në shkolla, departamenteve institucionale relevante, prindërve dhe komunitetit në afërsi të shkollës.					
<u>Treguesi i rezultatit</u>	Numri i fëmijëve jashtë shkollës të identifikuar Numri i fëmijëve jashtë shkollës të integruar					
Aktivitetet	Përgjegjësit	Palët Ndhimese	Afati kohore	Kosto	Burimi i financimit	Treguesit
1.1 Aplikimi i sistemit standard si bazë e të dhënave për sigurimin e informatave për fëmijët jashtë shkollës nga institucionet- zyrat relevante	DKA – Zyrtari i Arsimit	EPMRB e shkollës ZKKK QPS Mirëqenie sociale dhe Shëndetësisë Policia Regjistrimi Civil OJQ	Q1&Q4	SKA	SKA	Baza e të dhënave për të regjistruar informatat për fëmijët e identifikuar jashtë shkollës duke specifikuar edhe emrat e institucioneve të cilat ndajnë të dhënat
1.2 Aplikimi i mekanizmave referues, ndarja e përgjegjesisë, dhe përgjegjësit/personat kyç në çdo nivel dhe për çdo faze të referimit	DKA – Zyrtari i Arsimit EPMRB e shkollave	ZKKK QPS RC OJQ Policia MS DSH	Q1&Q4	SKA	SKA	Sistemi referues dhe emrat e personave kyç të fazave,

1.3 -Aplikimi i formularit standard për të regjistruar rastet e fëmijëve jashtë shkolle përmes identifikimit dhe adresimit të shkaqeve dhe specifikave duke funksionuar në parimin se të dhënat do të mbrohen/do të jenë konfidenciale	Shkollat - EPBRM	DKA Zyrat relevante OJQ	Q1&Q4	SKA	SKA	Formulari për regjistrim i aplikuar me të dhënat për profilin akademik dhe socio ekonomik
1.4 - Shfrytëzimi i qasjeve alternative për identifikimin dhe sigurimin e të dhënave përmes daljes në terren për të identifikuar fëmijë jashtë shkollës dhe profilin e tyre social e akademik.	Mësimdhënësit EPMRB Shkollat	DKA OJQ Zyrat relevante	Q1&Q4	20 x11=220	SHKOLLAT DONATOR TË MUNDËSHEM	Udhëtimet në terren, numri i fëmijëve të identifikuar me informata për profilin social dhe akademik
1.8 Rishikimi vjetor i sistemit/bazës së të dhënave dhe qasjeve për të mësuar për përmirësimin e praktikave të aktiviteteve të ndërmarra deri më tani, dhe definimi i nevojave dhe mundësive në vazhdim	DKA	Shkollat EPBRM Zyrat relevante OJQ	Q4	SKA	SKA	Analizë e funksionimit të praktikave të aplikuara

<u>OBJEKTIVI - 3</u>	Fuqizimi i kontestit profesional të komunitetit të Institucioneve në Arsimin para universitar duke aplikuar dhe zhvilluar kapacitetet profesionale në trajtimin e specifikave në procesin e mësimdhënies dhe përkrahjes së nxënësve sipas nevojave të profilit social dhe akademik si dhe në përdorimin e gjuhës adekuate në raportet sociale brenda institucioneve dhe sigurimi personelit adekuat e të mjaftueshëm dhe infrastrukturës adekuate arsimore dhe hapësirave fizike bazuar në nevoja dhe trendët.					
<u>Treguesi i rezultatit</u>	Numrit të trajnimeve, sesioneve informuese, takimeve në kontest të avancimit të praktikave profesionale Numri i klasave, pajisjeve dhe hapësirave adekuate dhe infrastrukturë lehtësisht e qasshme					
Aktivitetet	Përgjegjësit	Palët Ndhimese	Afati kohore	Kosto	Burimi i Financimit	Treguesit
3.1 Fuqizimi e kapaciteteve profesionale të ekipeve për vlerësimin e nevojave arsimore të nxënësve - Ekipet e shkollave për vlerësimin e nxënësve në rastin e regjistrimit të nxënësve në arsimin e obliguar dhe Ekipit Komunal për Vlerësim Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore	DKA Shkollat MASHTI	QPS DSH OJQ	Q1&Q4	30 x11=330	DKA Shkollat MASHTI DONATOR TË MUNDËSHEM	Raportimi i përbërjes dhe raportet e punës
3.2 – Zhvillimi profesional i mësimdhënësve që punojnë me rastet në rrezik të braktisjes - Mësimdhënësve mbështetës dhe asistentëve	MASHT DKA	IPK FE Qendrat Burimore	SH1&Q4	1400	MASHT DKA DONATOR TË MUNDËSHEM	Numri i trajnimeve

3.3 - Organizimi i evenimenteve me karakter edukativ, sportiv, kulturor për të promovuar gjithë përfshirjen dhe aftësitë e diferencuara të njeriut.	SHKOLLA	DKRS OJQ	SH1&Q4	SKA	SKA	Numri i aktiviteteve sipas karakterit të aktivitetit
3.4 – Sensibilizimi i prindërve, mësimitdhënësve dhe drejtorëve për gjithë përfshirje	MASHTI DKA	OJQ QPS ZKKK Shkollat	SH1&Q4	SKA	SKA	Numri i udhëzuesve dhe kampanjave të mbajtura
3.5 – Organizimi i sesioneve informuese për rendësin e edukimit dhe arsimit dhe mundësitë e përfshirjes së nxënësve në nivelet pasuese dhe në profesione gjatë jete edhe përmes bashkëpunimit me institucione e organizata qe adresojnë çështjet e interesit të ndërsjellë.	SHFMU SHML	DKA KK BIZNESET OJQ	SH1&Q4	SKA	SKA	Numri i evenimenteve të organizuara
3.6 - Pajisja e klasave me elemente adekuate për fëmijët sipas aftësisë së diferencuar sociale, akademike e fizike	DKA	OJQ QB Shkollat	SH1&Q4	1400	DKA SHKOLLA DONATOR TË MUNDËSHEM	Numri i klasave dhe pajisjeve

3.7 – Sigurimi i materialit të nevojshëm didaktik sipas nevojave të veçanta arsimore	DKA	MASHT SHKOLLAT QB OJQ	SH1&Q4	700	DKA SHKOLLA MASHT QB DONATOR TË MUNDËSHEM	Sasia e materialit të ofruar për nxënësve
3.8 - Krijimi i hapësirave që lehtësojnë qasjen në institucione arsimore dhe adaptimi i hapësirave për qëndrim sipas nevojave fizike dhe akademike për lehtësimin e qasjeve arsimore – aplikimi i hapësirave të mësonjëtove si dhoma burimore.	DKA MASHTI SHKOLLA	Prindër DSH OJQ	SH1&Q4	3400	DKA SHKOLLA MASHT QB QSH DONATOR TË MUNDËSHEM	Numri i dhomave burimore dhe pozitive lehtësuese për qasje në objekt sikurse ambientin e jashtëm
3.9 – Zhvillimi i aktiviteteve që promovojnë parime për të drejtat e njeriut dhe diversitetin human në kontestin akademik, social dhe fizik edhe bazuar në referenca në kushtetutën, ligje dhe konventat lokale, nacionale dhe ndërkombëtare.	DKA SHKOLLAT	MASHTI Zyra për të drejtat e njeriut OJQ	Q1&Q4	30 x11=330	DKA Shkollat MASHTI DONATOR TË MUNDËSHEM	Numri i aktiviteteve dhe sesioneve informuese.